



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore

TREGUESIT STATISTIKORË TË SHËRBIMEVE POSTARE

Tremujori I 2018



Përmbajtje

I . HYRJE.....	3
II. PANORAMË E PËRGJITHSHME	3
III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE	4
1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare	4
2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare	6
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar	8
4. Treguesit e shërbimit ekspres.....	9

I . HYRJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesore të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesorë të tregut postar për tremujorin e parë të vitit 2018 dhe krahasimet me tremujorin e katërt të vitit 2017 dhe me tremujorin e parë të vitit 2017, i cili publikohet në faqen e Internetit të AKEP www.akep.al, në seksionin “Shërbim Postar”-“Tregu Postar Statistika”- “Statistika të tregut postar”.

Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore të shërbimeve postare.

II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor janë paraqitur të dhënat periodike statistikore të shërbimeve postare për tremujorin e parë të vitit 2018 të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në regjistrin e AKEP në vitin 2017 janë:

- **Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.**
- **Ofruesit e shërbimeve postare (11 subjekte):**
 1. Albanian Cargo Service sh.p.k (A.C.S)
 2. Albanian Courier sh.p.k (A.C)
 3. Albanian Delivery Express sh.p.k (ADEx)
 4. DHL International (Albania) sh.p.k
 5. RAD MAIL sh.p.k
 6. Sky Net Logistic sh.p.k
 7. TNT Express Albania sh.p.k
 8. Ulysses Enterprises sh.p.k (Fedex)
 9. United Transport sh.p.k (Uni Trans)
 10. Youth Albania Professional Services (YAPS)
 11. Fast-Delivery sh.p.k

Posta Shqiptare me VKD Nr.2581, datë 22.06.2015 është pajisur nga AKEP me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar.

Subjekti Fast-Delivery Sh.p.k është pajisur me Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare në datën 9.10.2017 dhe ka nisur ofrimin e shërbimit në datën 1.12.2017.

III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore postare të dërguara përmbajnë kryesisht:

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare
2. Treguesit e shërbimit universal postar;
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar;
4. Treguesit e shërbimit ekspres

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2018 rezultojnë 5,969,251 objekte postare të pranuar dhe të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, të detajuara si më poshtë:

Tabela 1.1- Të dhëna përmbledhëse të objekteve postare sipas shërbimeve postare të ofruara në tremujorin e parë 2018 dhe krahasimi me tremujorin e katërt 2017 dhe me tremujorin e parë 2018.


Shërbime postare të ofruara		T1_2017	T2_2017	T3_2017	T4_2017	T1_2018	Ndryshim T1_2018/ T4_2017	Ndryshim T1_2018/ T1_2017
Posta Shqiptare sh.a								
1	Shërbim Universal Postar							
1.1	Postë brenda vendit	5,548,709	4,927,599	4,569,684	4,553,670	4,398,326	-3.4%	-20.7%
1.2	Postë ndërkombëtare	299,110	286,303	315,283	422,062	366,173	-13.2%	22.4%
1.3	Totali 1.1+1.2	5,847,819	5,213,902	4,884,967	4,975,732	4,764,499	-4.2%	-18.5%
2	Shërbim joniversal postar							
2.1	Postë brenda vendit	605,046	659,604	677,165	661,202	540,222	-18.3%	-10.7%
2.2	Postë ndërkombëtare	1,424	784	932	1,248	445	-64.3%	-68.8%
2.3	Totali 2.1+2.2	606,470	660,388	678,097	662,450	540,667	-18.4%	-10.9%
3	Shërbim ekspres							
3.1	Ekspres brenda vendit	175,121	187,646	185,715	176,312	163,968	-7.0%	-6%
3.2	Ekspres ndërkombëtar	7,121	6,394	6,058	6,191	4,611	-25.5%	-35%
3.3	Totali 3.1+3.2	182,242	194,040	191,773	182,503	168,579	-7.6%	-7%
Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare								
4	Shërbim Jo-Universal Postar							
4.1	Postë brenda vendit	37,285	53,710	60,880	113,894	118,115	3.7%	216.8%
4.2	Postë ndërkombëtare	200	9,182	7,657	9,473	143,846	1,418.5%	71,823.0%
4.3	Totali 4.1+4.2	37,485	62,892	68,537	123,367	261,961	112.3%	598.8%
5	Shërbim ekspres							
5.1	Ekspres brenda vendit	150,337	252,156	271,822	303,023	188,075	-37.9%	25.1%
5.2	Ekspres ndërkombëtar	42,755	50,947	48,056	54,721	45,470	-16.9%	6.4%
5.3	Totali 5.1+5.2	193,092	303,103	319,878	357,744	233,545	-34.7%	21.0%
6	Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3	6,867,108	6,434,325	6,143,252	6,301,796	5,969,251	-5.3%	-13.1%

Tabela 1.2: Totali i objekteve postare (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare) T1-2018

	Objekte postare	Pjesë tregu
<i>P.Sh</i>	5,473,745	92%
<i>Of. e tjerë</i>	495,506	8%
Totali	5,969,251	100%

Për sa rezulton nga të dhënat e reflektuara në tabelën 1.1 sa më sipër, për tremujorin e parë të vitit 2018 Posta Shqiptare zë rreth **92 %** të tregut postar përkundrejt Ofruesve të tjerë të shërbimeve postare të cilët së bashku zënë **8 %**.

Grafiku 1.1: Totali i shërbimeve postare, krahasimi në 3-mujorë




Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.1 më sipër, Posta Shqiptare në tremujorin e parë 2018 ka realizuar 5,473,745 shërbime postare, shifër e cila përkthehet në 346,940 objekte postare më pak se tremujori i katërt 2017, sikundër ofruesit e shërbimeve postare në tremujorin e parë 2018 kanë realizuar 14,395 objekte postare më shumë se në tremujorin katërt të vitit 2017, me një rritje rreth 3%.

Tabela 1.3: Totali i objekteve postare sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T1-2018

Sh.U	Sh. jo univers.	Sh.ekspres	Totali
4,764,499	802,628	402,124	5,969,251
79.8%	13.4%	6.7%	100%

Nga të dhënat e raportuara rezulton se volumin më të madh të objekteve postare e zë shërbimi universal postar me rreth 80% ose 4,764,499 objekte postare, ndjekur nga shërbimi jo universal me rreth 13% ose 802,628 objekte postare. Shërbimi ekspres zë 7 % ose 402,124 objekte postare.

Grafiku 1.2 Ecuria në 3-mujorë sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare



Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.2, vërehet qartë që pjesën më të madhe të shërbimeve postare e zë Shërbimi Universal Postar, i cili luhetet në nivelet rreth 83% për tremujorin e parë të vitit 2017, në rreth 80 % në tremujorin e parë të vitit 2018. Nga krahasimi i periudhës T1-2018 me periudhën T4-2017, vërehet një tkurrje e numrit të shërbimeve postare në masën 332,545 shërbime, sikundër nga krahasimi i tremujorit të parë të vitit 2018 me tremujorin e parë të vitit 2017 vërehet një rritje e shërbimeve postare në masën rreth 102,143 shërbime.


2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare

Tabela 1.4: Shërbimi Universal Postar T1-2018

Shërbimi Universal Postar	
Postë brenda vendit	4,398,326
Postë ndërkombëtare	366,173
Totali	4,764,499

Nga të dhënat e tabelës 1.3 vihet re se gjatë tremujorit të parë 2018, për sa i përket shërbimit Universal Postar, Posta Shqiptare realizoi gjithsej 4,764,499 objekte, nga të cilat Postë brenda vendit 4,398,326 ose 94%, dhe Postë ndërkombëtare 366,173 objekte, ose 6%. Për sa i përket Shërbimit Universal brenda vendit, janë regjistruar 3,567,819 shërbime për objekte të thjeshta dhe 830,507 shërbime për Objekte të regjistruara/shërbime të veçanta. Në lidhje me Shërbimin Universal Postar Ndërkombëtar, janë regjistruar 77,464 objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit dhe 288,709 objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.

Grafiku 1.3: Shërbimi universal postar - Ecuria në 3 mujë



3. Treguesit e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare


Në vijim paraqiten treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, të dërguara nga Posta Shqiptare:

Tabela 1.5: Treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, P. Shqiptare

Llojet e shërbimeve	Nr. Objekteve	Pjesa tregut
Shërbim universal postar	4,764,499	87%
Shërbim jo universal postar	540,667	10%
Shërbim ekspres	168,579	3%

Nga të dhënat e Tabelës 1.4 vihet re se volumin kryesor në shërbimet postare që ofron Posta Shqiptare e zë shërbimi universal me 4,764,499 objekte postare ose 87%, i ndjekur nga shërbimi jo universal me 540,667 objekte postare ose 10%, dhe shërbimi ekspres me 168,579 objekte postare ose 3%.

Grafiku 1.4: Llojet e shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare – Ecuria në 3-mujorë



Grafiku 1.4 paraqet ecurinë e objekteve postare të Posta Shqiptare gjatë 3-mujorëve të vitit 2017 dhe 3-mujorit të parë të vitit 2018, nga ku vihet re një rënie në numrin e objekteve postare për të treja kategoritë shërbimit universal, shërbimit jo universal dhe shërbimit ekspres e krahasuar kjo me tremujorin e katërt vitit 2017. Gjithashtu, rënie ka edhe nga krahasimi i tremujorit të parë 2018 me tremujorin e parë 2017.

4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim jepen të dhënat statistikore të marra së bashku për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimin jo universal.

Tabela 1.6: Shërbimi jo universal postar (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare)

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesa tregut
P. Shqiptare	540,667	67%
Of. e tjerë	261,961	33%
Totali	802,628	100%

Nga të dhënat e raportuara rezulton se për sa i përket shërbimit jo universal postar, treguesit më të mirë i ka Posta Shqiptare me 540,667 objekte postare ose 67% të tregut, kundrejt ofruesve të tjerë me 261,961 objekte postare ose 33%.

Grafiku 1.5: Shërbimi jo universal postar, Posta shqiptare/ofruesit e tjerë. Ecuria në 3-mujorë



Për sa i përket shërbimit jo universal, objektet postare të realizuara në tremujorin e parë 2018 krahasuar me tremujorin e katërt 2017 janë ulur për Postën Shqiptare me 121,783 objekte, ndërsa për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare janë rritur me 138,594 objekte. Nga krahasimi mbi bazën e periudhave tremujore, konstatohet rënie graduale e pjesëve të tregut të Postës Shqiptare për këtë shërbim, ku nga rreth 94 % që zinte në tremujorin e parë të vitit 2017, pjesa e tregut të Postës Shqiptare për këtë tregues ka arritur në rreth 67%.

Numri i objekteve të shërbimit jo-universal postar për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare gjatë tremujorit të parë të vitit 2018 përbëhej nga 658,337 objekte brenda vendit dhe 144,291 objekte për shërbimin jo-universal jashtë vendit.


5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë

Në vijim paraqitet informacion mbi treguesit e shërbimit postar ekspres për periudhën e tremujorit të parë të vitit 2018, si edhe të dhënat për periudhat krahasuese për vitin 2017, mbi baza tremujore.

Tabela 1.7: Shërbimi ekspres (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare) për tremujorin e parë 2018.

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesa tregut
P. Shqiptare	168,579	42%
Of. e tjerë	233,545	58%
Totali T1-2018	402,124	100%

Grafik 1.6: Shërbimi ekspres - Posta shqiptare/ofruesit e tjerë, Ecuria ne 3-mujore



Siç vihet re, për sa i përket shërbimit ekspres, gjatë tremujorit të parë të vitit 2018 ka pasur rritje të shërbimeve postare ekspres e krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit 2017, sikundër vërehet rënie në shërbimet postare ekspres për tremujorin e parë të vitit 2018 e krahasuar kjo me tremujorin paraardhës (T4 – 2017). Gjithashtu, edhe për shërbimin ekspres vërehet një rënie e pjesëve të tregut për postën Shqiptare, ku nga rreth 49% të tregut për këtë tregues në tremujorin e parë të vitit 2017, pjesa e tregut të postës shqiptare në tremujorin e parë të vitit 2018 ka arritur në rreth 42%, përkundrajt rreth 58% të ofruesve të tjerë.

Shërbimi ekspres brenda vendit për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë së bashku është në vlerat 352,043 objekte postare ose 88%, dhe shërbimi postar ekspres ndërkombëtar në vlerën 50,081 objekte postare ose 12%.

Përsa i përket postës ndërkombëtare në shërbimin ekspres, sasia e objekteve hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri paraqitet në vlerën 29,883 objekte postare, shifër kjo dukshëm më e madhe se sasia e objekteve postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit në vlerë 20,198 objekte.